



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 6.5.2023

Nr: 456

Ora: 12:30

V E N D I M

P Ë R

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 387 NGA PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË, PËR HEQJE TË MATERIALEVE ZGJEDHORE TË VENDOSURA NË KUNDËRSHTIM ME LIGJIN NGA KOALICIONI "BASHKË FITOJMË", NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 6.5.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Partia Socialiste e Shqipërisë, dega Kavajë

SUBJEKT : Koalicioni "Bashkë Fitojmë"

OBJEKTI: Vendosja e një posteri të madh të kandidatit të Koalicionit "Bashkë Fitojmë" mbi fasadën e godinës së Postës Shqiptare, në qendër të qytetit Kavajë

BAZA LIGJORE: Nenet 19, pikat 1, shkronja "dh", "f", "n", e 2 dhe 79, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, udhëzimi nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore",

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është administruar denoncimi me nr. 3944 prot., datë 19.4.2023, me denoncues subjektin zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", dega Kavajë. Denoncimi është regjistruar me nr. 387 ID, të regjistrimit të denoncimeve. Nëpërmjet

Data: 6.5.2023 Nr: 456
Ora: 12:30



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 387 nga Partia Socialiste e Shqipërisë, për heqje të materialeve zgjedhore të vendosura në kundërshtim me ligjin nga Koalicioni "Bashkë Fitojmë", në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023".

këtij denoncimi pretendohet se *“Në Bashkinë Kavajë është konstatuar afishimi i materialeve propagandistike mbi fasadën e godinës së Postës Shqiptare, nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”.*

Pala kërkuese kërkon heqjen e menjëhershme të materialeve propagandistike të vendosura në kundërshtim me ligjin.

Në përgjigje të këtij denoncimi, KQZ filloi hetimin administrativ përkatës. Në kuadër të këtij hetimi administrativ, monitoruesit të caktuar nga KQZ-ja për monitorimin e Bashkisë Kavajë, nëpërmjet postës elektronike e-mail, ju kërkua informacion në lidhje me afishimin e këtyre materialeve propagandistike nëse vazhdojnë të jenë akoma të afishuara.

Nëpërmjet e-mail të datës 19.4.2023, me lëndë *“Kërkesë për heqje materiali propagandistik”* i është kërkuar subjektit zgjedhor Koalicioni *“Bashkë Fitojmë”*, marrja e masave të menjëhershme për heqjen e materialit propagandistik, në kundërshtim me përcaktimet e udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021. Gjithashtu rezultoi se ky material propagandistik nuk përmban shënimin *“Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të ...”* (vijon emri i subjektit zgjedhor).

Më datë 3.5.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, miratoi vendimin nr. 424, *“Për heqjen e materialeve propagandistike që nuk përmbajnë shënimin “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të ...”* (vijon emri i subjektit zgjedhor) nëpërmjet të cilit ngarkohet Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake për heqjen e të gjitha materialeve propagandistike të cilat nuk e përmbajnë këtë shënim.

Me shkresën nr. 4640 prot., si dhe nr. 4651 prot., datë 4.5.2023 i është përcjellë vendimi nr. 424, datë 3.5.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të gjitha bashkive si dhe Policisë së Shtetit.

Pas verifikimit të të dhënave, provave dhe fakteve, si dhe raportit të monitorimit, vlerësoj se materialet propagandistike janë vendosur në kundërshtim të nenit 3, pika 2, të udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve *“Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”*,

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja *“dh”, “f”, “n”,* e 2 dhe 79, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, *“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar, si dhe udhëzimin nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve *“Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”*,

V E N D O S:

1. Urdhërimin e Policisë Bashkiake Kavajë dhe Policisë së Shtetit për heqjen e menjëherëshme të materialit propagandistik mbi fasadën e godinës së Postës Shqiptare, Kavajë, të subjektit zgjedhor Koalicioni *“Bashkë Fitojmë”*.

Data: 6.5.2023 Nr: 456
Ora: 12:30



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 387 nga Partia Socialiste e Shqipërisë, për heqje të materialeve zgjedhore të vendosura në kundërshtim me ligjin nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

2. Ky vendim i njoftohet subjektit zgjedhor Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, Policisë së Shtetit si dhe Policisë Bashkiake Kavajë nëpërmjet postës elektronike.
3. Ngarkohen për zbatim të menjëhershëm të këtij vendimi Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake Kavajë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 6.5.2023 Nr: 456
Ora: 12:30



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 387 nga Partia Socialiste e Shqipërisë, për heqje të materialeve zgjedhore të vendosura në kundërshtim me ligjin nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.